

**U D H Ë Z I M**  
**Nr.5, datë 17.10.1994**

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.3, DATË  
21.6.1993, DHE NË UDHËZIMIN NR.13, DATË 18.10.1993 “PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR  
KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE ISH-PRONARËVE”**

Në mbështetje të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, me propozimin e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, Këshilli i Ministrave,

**U D H Ë Z O N:**

1. Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 21.6.1993, në pikën 14 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kur dega e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit bën publikimin në shtyp të objekteve që privatizohen, personi që ka paraqitur kërkesën për t’u njohur si ish-pronar i truallit mbi të cilin është ndërtuar objekti, ka të drejtë të kërkojë me shkrim në komisionin e kthimit dhe kompensimit të pronave shqyrtimin e përshpejtuar të çështjes së tij, kur paraqet mandat-pagesën sipas kërkesave të degës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

Në këtë rast komisioni duhet që pesë ditë para mbledhjes së bordit të degës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit t’i dorëzojë vendimin e komisionit personit pretendues”.

2. Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.13, datë 18.10.1993, në fund të pikës 7 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Kur deklaratimet zyrtare janë negative, prona për të cilën pretendohet, të trajtohet si pronë e marrë nga shteti pa të drejtë me çdo mënyrë tjetër, në përputhje me nenin 1 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**